

VENDIM
Nr.585, datë 23.8.2006

**PËR HAPJEN E KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË NJU-JORK, SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Nju-Jork, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha